



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLICA OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË ACADEMY OF JUSTICE			
Niveli, Org. Org. Jeshin, Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	358
Nr. Faneve No. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	26.07.2023
Prishtinë / a			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

Nr: 01/358/2023

Datë: 25.07.2023

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.1) dhe nenit 11 (paragrafi 4) të Ligjit Nr. 05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur me datë 25.07.2023, merr këtë:

**VENDIM**

- I. Miratohet Rregullorja Nr. 01/2023 për Plotësim dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 02/2019 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë

Vendimi u dërgohet:  
Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë  
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**

*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

Në bazë të nenit 10 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe në pajtim me nenin 24 paragrafin 7 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e datës 25.07.2023, Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, miraton këtë:

**RREGULLORE**  
**(AD) NR.01/2023**  
**PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR.02/2019**  
**PËR**  
**PËR TRAJNUESIT DHE MENTORËT E AKADEMISË SË DREJTËSISË**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregullore është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores nr.02/2019 për trajnuesit dhe mentorët e Akademisë së Drejtësisë (në tekstin në vijim Rregullorja bazike).

**Neni 2**

Neni 3, paragrafit 1 të rregullores bazike i shtohet nën paragrafi 1.9, me përmbajtjen në vijim:

1.9 “Trajnues ndërkombëtarë” janë trajnuesit e huaj ose vendor të cilët punojnë për ose në emër të organizatave ndërkombëtare, partnere të Akademisë.

**Neni 3**

1. Tek neni 4 paragrafi 1 i rregullores bazike, pas fjalës përhershëm shtohet fjalia me përmbajtjen në vijim: Akademia, sipas nevojës, mund të angazhojë edhe trajnues ndërkombëtarë.

2. Tek neni 4 i rregullores bazike, pas paragrafit 2, shtohen paragrafët 3, 4, 5 dhe 6 me përmbajtjen si në vijim:

3. Në veçanti, trajnuesit kryejnë por duke mos u kufizuar në aktivitetet e mëposhtme të Akademisë:

3.1.Marrin pjesë në elaborimin e planeve dhe programeve vjetore dhe planeve tjera të trajnimit, në vlerësimin e nevojave për trajnim, vlerësimin e trajnimeve dhe të trajnuarve dhe në aktivitete të tjera, që janë pjesë e ciklit të trajnimeve;

3.2.Zhvillojnë kurse trajnimi, module dhe programe tjera;

3.3.Mbajnë ligjërata, prezantime; mban orë, panele, konferenca dhe të tjera;

- 3.4. Moderojnë dhe fasilitojnë diskutimet, tryezat e rumbullakëta dhe seminarët tjerë;
  - 3.5. Përgatisin materiale të tjera të shkruara ose vizuale, që do të përdoren si mbështetje për seancat e tyre të trajnimit ose për publikim;
  - 3.6. Marrin pjesë në trajnime me prezencë fizike dhe online;
  - 3.7. Vlerësojnë pjesëmarrësit në trajnimin fillestar, me gojë ose me shkrim, përfshirë materialet hulumtuese dhe detyrat tjera me shkrim, siç kërkohet me program/ kurrikulë;
  - 3.8. Marrin pjesë në hulumtime, publikime dhe aktivitete tjera, sipas Nenit 6, nën-paragrafit 1.8 dhe 1.9 të Ligjit për Akademinë.
4. Të drejtat e autorit mbi planet e trajnimit, kurset, modulet, programet e trajnimit, prezantimet, trajnimet dhe materialet tjera të shkruara ose vizuale dhe mbi objektet tjera të pronësisë intelektuale të prodhuara nga ose me pjesëmarrjen e trajnuesve për nevojat e Akademisë i përkasin Akademisë, dhe përfshihen në kontratën e angazhimit të trajnerit. Akademia mund t'i përdorë, riprodhojë, përditësojë, modifikojë, publikojë lirisht ato për aktivitetet e saj.
  5. Të gjitha materialet sipas paragrafit 4 të këtij neni, të porositura ose të prodhuara për Akademinë e Drejtësisë e kanë shenjën e të drejtës së autorit dhe një deklaratë të qartë se e drejta e autorit i përket Akademisë dhe askush nuk mund t'i përdorë apo riprodhojë ato pa pëlqimin e saj.
  6. Trajnuesit mund të përdorin materialet e pronësisë intelektuale të përmendura në paragrafin 4 të këtij neni me pëlqimin e Akademisë, megjithatë me një deklaratë të qartë se ato janë zhvilluar nga/për Akademinë që ka të drejtën e autorit mbi to.

#### **Neni 4**

1. Tek neni 7 i rregullores bazike, pas paragrafit 2, shtohen paragrafët 3, 4, 5 dhe 6 me përmbajtjen si në vijim:

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e trajnuesve sipas paragrafit 1 të këtij neni janë si në vijim:

- 3.1 Të marrë pjesë në shqyrtimin e planeve dhe programeve vjetore të trajnimit, në vlerësimin e nevojave, vlerësimin e trajnimeve dhe pjesëmarrësve, si dhe në aktivitetet tjera, si pjesë e ciklit të trajnimeve;
- 3.2 Të zhvillojë kurse të trajnimit, moduleve, programeve dhe të tjera;
- 3.3 Të realizojë ligjërata, prezantime: të mbajë kurse, panele, konferenca dhe të tjera;
- 3.4. Të moderojë dhe fasilitojë diskutime, tryeza, punëtori dhe të tjera;
- 3.5. Të përgatisë materiale trajnuese dhe të tjera me shkrim ose vizuale, që do të përdoren gjatë sesioneve të tyre trajnuese, ose për publikim;
- 3.6. Të marrë pjesë në trajnimet e realizuara me prezencë fizike dhe në ato online.
- 3.7. Të vlerësojnë pjesëmarrësit në trajnimin fillestar, me gojë dhe me shkrim, duke i përfshirë edhe materialet e tyre hulumtuese dhe detyrat tjera me shkrim, siç kërkohet me program/ kurrikulë;
- 3.8. Të marrë pjesë në hulumtime, publikime dhe aktivitete tjera, sipas Nenit 6 nën-paragrafët 1.8 dhe 1.9 të Ligjit për Akademinë.

4. Trajnuesit, nga paragrafi 1 i këtij neni caktohen në kurse konkrete të trajnimit, module dhe ngjarje në përputhje me Nenin 9A të Rregullores. Detyrat konkrete ju caktohen nga ana

e Udhëheqësit të Departamentit ose Divizionit, në të cilin ata janë caktuar si trajnues, dhe të cilëve ju raportojnë për performancën e tyre.

#### **Neni 5**

Neni 8 i rregullores bazike, riformulohet si në vijim:

#### **Neni 8**

#### **Trajnuesit e përkohshëm**

1. Trajnuesit e përkohshëm janë gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë të universitetit ose ekspertë të angazhuar sipas nevojave për zbatimin e programit të trajnimit.
2. Për t'u përzgjedhur dhe për të shërbyer si trajnues të përkohshëm, kandidatët duhet t'i plotësojnë kriteret e mëposhtme:
  - 2.1 Të kenë së paku 5 vite punë profesionale në fushën apo temën në të cilën do të angazhohen;
  - 2.2 Të kenë përvojë si trajnues, ose të ketë përfunduar trajnimin e trajnuesve të organizuar nga Akademia ose institucionet tjera të ngjashme, konsiderohet përparësi;
  - 2.3 Të jenë vlerësuar pozitivisht kur ka qenë i angazhuar si trajner nga Akademia;
  - 2.4 Të kenë cilësi të larta profesionale dhe morale;
  - 2.5 Të mos ketë qenë i dënuar për vepra penale, të mos jetë subjekt i procedurës penale dhe të mos jetë subjekt i sanksioneve disiplinore në pesë vitet e fundit, me përjashtim të masës së qortimit jopublik.
  - 2.6 Të kenë përvojë ose kompetencë të dëshmuar në fushën, kursin, modulën ose temën për të cilën aplikon.
3. Trajnuesit e përkohshëm angazhohen në bazë të kontratës për shërbime të veçanta, sipas nevojës për zbatimin e programit të trajnimit. Kontrata i referohet qartë termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Rregullore si dhe Udhëzuesve për Trajnues.
4. Trajnuesit e përkohshëm të miratuar përfshihen në listën e Akademisë për një periudhë prej tri viteve, pas së cilës ata mund të aplikojnë sërish. Paraqitja teknike e listës miratohet nga Drejtori. Lista publikohet në faqen e internetit të Akademisë.
5. Anëtarët e Këshillit Drejtues dhe Këshillit Programor gjatë mandatit të tyre nuk angazhohen si trajnues të përkohshëm.

#### **Neni 6**

Neni 9 i rregullores bazike riformulohet si në vijim:

#### **Neni 9**

#### **Procedura për zgjedhjen e trajnuesit të përkohshëm**

1. Trajnuesit e Akademisë përzgjidhen në bazë të një procesi konkurrimi të hapur i cili zhvillohet të paktën një herë në vit ose *ad hoc*, varësisht nga nevojat e programit vjetor të trajnimit.

2. Në procesin e shpalljes publike për zgjedhjen e trajnuesve të Akademisë, merren parasysh kriteret e përcaktuara me këtë rregullore.
3. Trajnuesit e përfshirë si përfaqësues të institucioneve jogjyqësore, përderisa natyra e trajnimit kërkon ekspertizën nga këto institucione, konsiderohen si përjashtim nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni. Ata propozohen nga institucioni përkatës me kërkesë të Akademisë.
4. Përjashtimisht, Akademia mund të angazhojë trajnues nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve ose ekspertëve individualë jo gjyqësorë edhe jashtë listës së përzgjedhur të konkursit të hapur, vetëm në rastet kur lista e trajnuesve nuk plotëson nevojat për zbatimin e programit të trajnimit ose mund të propozohen dhe certifikohen si trajnues nga projektet e ndryshme, të cilët janë mbështetës dhe zbatues të punës së Akademisë, me kusht që t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore.
5. Trajnuesit ndërkombëtar mund të angazhohen jashtë kushteve të përgjithshme dhe procedurave të parashikuara në Nenet 8 dhe 9 të kësaj Rregullore. Ata miratohen nga Këshilli Drejtues me propozim të drejtpërdrejtë nga Drejtori Ekzekutiv, përfshirë edhe kushtet financiare të këtij angazhimi.
6. Njoftimi për aplikim për trajnim të përkohshëm publikohet në faqen zyrtare të Akademisë. Njoftimi i dërgohet KGJK-së dhe KPK-së për publikim në faqet e tyre të internetit, si dhe gjykatave, prokurorive dhe institucioneve dhe organizatave të tjera të përshtatshme për shpërndarje.
7. Aplikimi bëhet përmes plotësimit të formularit të aplikimit dhe dorëzimit të tij në Akademi në kopje fizike ose elektronike. Përmbajtja teknike e formularit të aplikimit miratohet nga Drejtori. Formularit të aplikimit i bashkëngjiten dokumentet e mëposhtme:
  - 7.1 Biografia (CV);
  - 7.2 Emërtimi i modulit, kurseve ose temave për të cilat aplikojnë si trajnues;
  - 7.3 Një koncept që përmban boshllëqet/problemet që duhen adresuar, qëllimet dhe objektivat e kursit, karakteristikat e audiencës dhe pjesëmarrësve, përmbajtjen e kursit, metodën dhe teknikën e trajnimit, planin e kursit, mediat dhe pajisjet, materialet dhe detyrat e kursit, mjetet e reagimit dhe vlerësimit. Përmbajtja teknike e konceptit miratohet nga Drejtori Ekzekutiv;
  - 7.4 Dëshmi për përvojën ose kompetencën e tyre në fushën, kursin, modulën ose temën për të cilën aplikojnë.
8. Akademia e përgatitë listën e kandidatëve të cilët i përmbushin kriteret për trajnues. Mund të kërkohen informata nga Komisionet për Vlerësim të Performancës në KGJK dhe KPK dhe nga burimet tjera zyrtare për vlerësimin e cilësive profesionale dhe morale të aplikuesve. Mund të mbahen intervista me aplikuesit.
9. Drejtori Ekzekutiv pas konsultimit me Këshillin Programor, i propozon për miratim Këshillit Drejtues të Akademisë listën e trajnuesve. Lista mund të përmbajë më shumë se një trajnues për modul, kurs ose temë, varësisht nga nevojat e Akademisë.
10. Kandidatët që nuk pranohen si trajnues kanë të drejtë të ankohen në Këshillin Drejtues brenda tetë (8) ditëve, pas pranimit të njoftimit, për arsyet që lidhen me anën formale të procedurës dhe kriteret e përzgjedhjes.

## Neni 7

Pas nenit 9 të rregullores bazike, shtohet neni i ri 9A, me përmbajtjen si në vijim:

### Neni 9 A

#### **Mënyra e angazhimit të trajnuesve në trajnime**

1. Angazhimi i trajnuesve në trajnime mvaret nga programi trajnues i miratuar nga Këshilli Drejtues.
2. Këshilli Drejtues mund të angazhojë një trajnues për maksimum pesë (5) module trajnimi gjatë një viti kalendarik.
3. Përfshirja në listën e trajnuesve të miratuar nga Këshilli Drejtues, nuk u garanton me automatizëm edhe angazhim të trajnueseve në trajnime.
4. Angazhimi i trajnuesve në trajnime mvaret nga:
  - 4.1. Objektiva specifike e trajnimit.
  - 4.2. Ekspertiza përkatëse e trajnuesit.
  - 4.3. Vlerësimi i punës së trajnuesit.
5. Në rastet kur dy apo më shumë trajnues në mënyrë të barabartë i plotësojnë kushtet e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni, Akademia e Drejtësisë do të bëjë angazhimin e tyre në mënyrë racionale.

## Neni 8

1. Titulli i nenit 10 të rregullores bazike riformulohet me përmbajtjen si në vijim:  
**Të drejtat, detyrat dhe kompensimi i trajnuesve**
2. Tek neni 10 i rregullores bazike, pas paragrafit 8 shtohen paragrafët 9 dhe 10 me përmbajtjen si në vijim:
  9. Trajnuesit respektojnë standardet për metodologjinë e trajnimit dhe materialet e trajnimit të përcaktuara në Doracakun për Trajnues të Akademisë, si dhe konceptin për kursin, modulën ose temën përkatëse për të cilën kanë aplikuar, me kusht që kjo të jetë në përputhje me standardet e Akademisë.
  10. Trajnuesit duhet t'u përmbahen dispozitave të së drejtës së autorit siç përcaktohet me legjislacionin përkatës të së drejtës së autorit. Akademia e Drejtësisë nuk mban asnjë përgjegjësi për shkeljet e mundshme të kësaj të drejte nga trajnuesit.

## Neni 9

Neni 11 i rregullores bazike, riformulohet me përmbajtjen në vijim:

### Neni 11

#### **Përgjegjësitë specifike të trajnuesve**

1. Trajnuesit e Akademisë së Drejtësisë kanë këto përgjegjësi:

- 1.1 Të ofrojnë trajnime fillestare, përkatësisht trajnime të vazhdueshme dhe/ose të specializuara në fushën përkatëse ligjore si dhe trajnime të detyrueshme në përputhje me programin e Akademisë;
- 1.2 Të përgatisin me shkrim materialet e trajnimit të cilat dorëzohen jo më vonë se 15 ditë para datës së trajnimit;
- 1.3 Të marrin pjesë në përgatitjen dhe realizimin e agjendës për trajnimet përkatëse ose forma të tjera të arsimit dhe formimit profesional;
- 1.4 Të marrin pjesë në përgatitjen e planit dhe programit vjetor të trajnimit të Akademisë dhe të kryejnë vlerësimin e nevojave për arsim dhe formim profesional;
- 1.5 Të analizojnë problemet dhe paqartësitë e identifikuar gjatë trajnimeve dhe të nxjerrë rekomandime të cilat i dërgohen Akademisë jo më vonë se 15 ditë pas trajnimit;
- 1.6 Të jenë të pranishëm në vazhdimësi dhe në mënyrë konstante gjatë trajnimeve ku janë të angazhuar;
- 1.7 T'i përmbahen angazhimeve për trajnimin përkatës, ndërsa nëse tërhiqen ose nuk janë në gjendje të angazhohen për trajnim, të njoftojnë Akademinë, 30 ditë para fillimit të trajnimit, përveç rasteve emergjente;
- 1.8 Të trajtojnë kolegët trajnues, pjesëmarrësit, stafin e Akademisë, përkthyesit dhe individët e tjerë të përfshirë në aktivitetet e Akademisë me respekt, dinjitet dhe mirësjellje, duke iu përmbajtur rregullave etike për gjyqtarë dhe prokurorë dhe/ose Rregullave të Mirësjelljes të përcaktuara në Doracakun për Trajnues të Akademisë;
- 1.9 T'ia shpalosin me kohë Akademisë aktivitetet në të cilat ata janë të përfshirë, të cilat mund të bien ndesh ose të jenë konkurruese me aktivitetet e Akademisë.

2. Ankesat lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e trajnuesve do të trajtohen në bazë të Doracakut për Trajnues të Akademisë.

#### **Neni 10**

Neni 12 i rregullores bazike, riformulohet me përmbajtjen si në vijim:

#### **Neni 12**

#### **Trajnimi i Trajnuesve**

1. Akademia angazhon trajnues të specializuar për TiT të cilët përgatisin dhe ofrojnë trajnime për trajnuesit e angazhuar nga Akademia.
2. Trajnuesit e specializuar për TiT, kanë njohuri të përgjithshme dhe të verifikuara mbi aspektet metodologjike dhe didaktike të trajnimit gjyqësor, në përputhje me standardet dhe metodologjinë e trajnimit të Akademisë, të përcaktuara në Doracakun për Trajnues të Akademisë.
3. Kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në nenin 8 të kësaj rregullore vlejnë edhe për trajnuesit e specializuar për TiT. Ata miratohen nga Këshilli Drejtues me propozim të drejtpërdrejtë të Drejtorit Ekzekutiv dhe pas certifikimit ose rekomandimit të institucionit që ka mbajtur kursin e avancuar të Trajnimit për Trajnues.
4. Trajnuesit e specializuar për TiT mund të aplikojnë dhe të përfshihen në listën e trajnuesve të përkohshëm sipas rregullave të përcaktuara me këtë rregullore.

## Neni 11

Neni 16 paragrafi 2 i rregullores bazike, riformulohet me përmbajtjen si në vijim:

2. Vlerësimi i trajnuesve dhe mentorëve bëhet një herë në vit nga Këshilli Drejtues me propozim nga Këshilli Programor, sipas kriterëve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

## Neni 12

Neni 17 i rregullores bazike, riformulohet me përmbajtjen si në vijim:

## Neni 17

### **Përfundimi dhe ndërprerja e statusit të trajnuesit ose mentorit**

1. Trajnuesit që nuk marrin vlerësim pozitiv për punën e tyre ose që shkelin detyrat dhe përgjegjësitë ose nuk i plotësojnë më kriteret e kësaj Rregulloreje, hiqen nga lista e trajnuesve, me vendim të Këshillit Drejtues të Akademisë.
2. Këshilli Drejtues i Akademisë lidhur me vlerësimin për mentorët, i njofton me shkrim KGJK-në dhe KPK-në.
3. Ndërprerja e marrëdhënies së punës për trajnuesit e përhershëm që janë nëpunës civil bëhet sipas procedurave të përcaktuara me dispozitat e legjislacionit për zyrtarët publik.
4. Propozimi në rastet e lartëcekura bëhet nga Drejtori Ekzekutiv, i shoqëruar me mendimin e Këshillit Programor. Trajnuesi përkatës mund të paraqesë mendimin me shkrim tek Këshilli Drejtues dhe mund të dëgjohet nga ky i fundit.

## Neni 13

### **Dispozitat kalimtare**

Deri në përzgjedhjen e trajnuesve sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, Akademia do të angazhojë trajnuesit nga lista ekzistuese e trajnuesve për realizimin e aktiviteteve trajnuese.

## Neni 14

### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë

Prishtinë, 25/07/2023